

VENDIM
Nr. 343, datë 12.6.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 911, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN “RSM”, NË SHTABE TË
NDRYSHME TË NATO-s, NË AFGANISTAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 911, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Numri “...11 (njëmbëdhjetë) ...” ndryshohet dhe bëhet “...15 (pesëmbëdhjetë) ...”;
 - b) Paragrafi i fundit së bashku me ndarjet ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Në Shtabin e Trajnim - Këshillimit dhe Ndihmës (TAAC-West), në operacionin “RSM”, në Herat, Afganistan:
 - Numri i pjesëmarrjes, 6 (gjashtë) ushtarakë;
 - Venddislokimi, Herat, Afganistan.”.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama